

Algjebër

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Algjebër		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I-rë		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	8		
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Qëndrim R. Gashi		
Detajet kontaktuese:	qendrim.gashi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Në këtë kurs studiohen grupet, përfshirë teoremat e Silovit, pastaj unazat dhe teoria e idealeve, dhe në fund fushat, për të kulmuar me teoremën themelore të teorisë Galua.		
Qëllimet e lëndës:			
	Qëllimi i kursit është që studentët të njoftohen me strukturat algjebrike të grupeve, unazave dhe fushave, si dhe disa veti të tyre themelore, si dhe t'i përdorin ato si dhe të menduarit abstrakt, qoftë në studime të mëtejme, qoftë për zbatime jashtë matematikës.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T'i identifikojë, sqarojë, përdor dhe analizojë nocionet e grupeve, unazave dhe fushave. • T'i analizojë disa veti themelore të grupeve të zgjidhshme, të p-grupeve dhe t'i përdor teoremat e Silovit; • T'i përkufizojë dhe vërtetojë pohime bazike për unazat, llojet e ndryshme të unazave, idealet në unaza dhe faktor-unazat e një unaze në lidhje me një ideal; • T'i përdor nocionet e fushave, zgjerimeve të fushës, faktorizimit të polinomit dhe fushës së zbërthimit, automorfizmeve të fushës dhe Teoremën themelore të teorisë Galua. • Të zbatojë jashtë matematikë nocionet e mbuluara në këtë kurs dhe të përdor në mënyrë të pavarur literaturën shkencore për studime të pavarura dhe kërkime shkencore. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			

Kollokuiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	11	1	11
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet ,etj	1	15	15
Totali			200
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Pjesëmarrja (5%) Detyrat e shtëpisë (10%) Kollokuiumi i parë (15%) Kollokuiumi i dytë (15%) Projekti (15%) Testi final (40%)		
Literatura:			
	E. Ademaj dhe E. Gashi, Algebra e Përgjithshme, Prishtinë (1986); D. S. Dummit and R. M. Foote, Abstract Algebra, Wiley (2004); J. B. Fraleigh, A First Course in Abstract Algebra, Pearson (2013)		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Hyrje. Grupet		
<i>Java e dytë:</i>	Nëngrupet		
<i>Java e tretë:</i>	Faktor-grupet dhe homomorfizmet		
<i>Java e katërt:</i>	Teoremat e izomorfimit		
<i>Java e pestë:</i>	Veprimet e grupeve		
<i>Java e gjashtë:</i>	Prodhimet e drejtpërdrejta		
<i>Java e shtatë:</i>	p-grupet, grupet nilpotente dhe grupet e zgjidhshme		
<i>Java e tetë:</i>	Teoremat e Syllovit		
<i>Java e nëntë:</i>	Hyrje në teorinë e unazave		
<i>Java e dhjetë:</i>	Idealet në unaza dhe faktor-unazat		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Unazat polinomiale		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Hyrje në teorinë e moduleve		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Elemente të teorisë së fushës		
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Elemente të teorisë së fushës (vazhdim)		
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Teorema themelore e Teorisë Galua		
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:			
Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i përcjellin të gjitha ligjëratat, ushtrimet dhe provimet. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të diskutojnë me njëri-tjetrin përderisa i shënojnë emrat e kolegëve me të cilët i kanë diskutuar detyrat si dhe resurset e përdorura.			

Ekonometria

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	FSHMN, Departamenti i Matematikës
Titulli i lëndës	Ekonometria
Niveli	Master
Statusi lëndës	Zgjedhore
Viti i studimeve	II
Numri i orëve në javë	2+2
Vlera në kredi – ECTS	6
Koha / lokacioni	Departamenti i Matematikës
Mësimdhënësi i lëndës	Prof. Ass. Dr. Edmond Aliaga
Detajet kontaktuese	edmond.aliaga@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Diagnostifikimi dhe metodat alternative të regresionit. Regresioni rezistent dhe kuantil. Testet diagnostike dhe testet për gabimet e forta standarde. Testet ANOVA një dhe dy kahore (me dhe pa përsëritje). Modelet lineare të përgjithësuara. Seritë kohore. Analiza klasike e bazuar në modele. Regresioni i serive kohore. Programimi i analizës vetjake – simulimet e ndryshme.
Qëllimet e lëndës	Ky kurs ka për qëllim që studentët të përforcojnë dhe të avancojnë me njohuritë e fituara nga lënda e Statistikës dhe Ekonometrisë gjatë studimeve Baçelor. Po ashtu, do të fitojnë njohuri të reja lidhur me lloje të ndryshme të regresioneve të cilat edhe do t'i zbatojnë praktikisht me anë të gjuhës programuese R. Përdorimi dhe zbatimi i paketave të ndryshme në kuadër të R që janë në shërbim të përpunimeve dhe analizave statistikore, do të jetë një prej prioriteteve në kuadër të këtij kursi.
Rezultatet e pritura të nxënies	Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje që të : <ul style="list-style-type: none">➤ kupton rëndësinë e një lidhjeje të duhur midis analizës ekonometrike dhe teorisë;➤ fillon të hulumtojë zgjerimet e modelit klasik të regresionit linear të përgjithshëm;➤ përvetëson bazat e modelit klasik të regresionit linear të përgjithshëm;➤ forcojë më tej aftësitë në përdorimin e softuerit statistikor/ekonometrik;➤ bën lidhje përkatëse midis teorisë dhe shembujve të botës reale, nëpërmjet referimeve në materiale të ndryshme.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	10	2	20
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			35
Përgatitja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			154
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, konsultime, diskutime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Punimet seminarike:	60%	
	Provimi final:	40%	
	Total:	100%	
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Kleiber, Christian and Zeileis Achim. (2008), "Applied Econometrics with R", Springer • Verbeek, M. (2017). A Guide to Modern Econometrics (Vol. 5th edition). Hoboken, NJ: Wiley. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Gujarati, Damodar "Basic Econometrics", Fourth edition. The McGraw –Hill.Saeed Ghahramani. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë</i>	Njohja me syllabusin e lëndës. Hyrje në lëndën e Ekonometrisë.
<i>Java e dytë</i>	Metodat alternative të regresionit.
<i>Java e tretë</i>	Testet diagnostike. Shembuj.
<i>Java e katërt</i>	Testet për gabimet e forta standarde.
<i>Java e pestë</i>	Testi ANOVA një kahore. Shembuj.
<i>Java e gjashtë</i>	Testi ANOVA dy kahore pa përsëritje.
<i>Java e shtatë</i>	Testi ANOVA dy kahore me përsëritje.
<i>Java e tetë</i>	Modelet lineare të përgjithësuara.
<i>Java e nëntë</i>	Seritë kohore. Analiza klasike e bazuar në modele.
<i>Java e dhjetë</i>	Regresioni i serive kohore
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Simulimet e ndryshme me anë të R.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Modelet një parametrike. Metoda Monte Carlo.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Përafrimi Monte Carlo.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Algoritmi MCMC. Diskutimet dhe referencat.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Shembuj të përgjithshëm.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.</p>

Internship

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Algjebër		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	II-të		
Numri i orëve në javë:	1+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Qëndrim R. Gashi		
Detajet kontaktuese:	qendrim.gashi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Ky është kurs ku studentët do të kenë mundësi që përmes një pune të strukturuar dhe të mbikëqyrur, ta zhvillojnë një përvojë të internshipit në një institucion ose kompani, publike apo private. Kursi përmban ligjërata orientuese, përgatitje për intervista si dhe ese e diskutime për përvojat e marra.		
Qëllimet e lëndës:			
	Qëllimi i kursit do të jetë përgatitja e studentëve për lidhjen ndërmjet studimeve dhe tregut të punës, për prezantim dhe komunikim profesional, ngritje të nivelit të përgjegjësisë dhe autonomisë së tyre, si dhe analizim të mundësive të zhvillimit profesional.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Ta avancojë mendimin e vet kritik dhe aftësitë për zgjidhje të problemeve, kapacitetin për punë në grupe, përdorimin e teknologjisë digjitale, aftësitë udhëheqëse, punën etike dhe vlerat e hapjes dhe të përfshirjes. • Të zbatojë përvoja e njohuri për komunikim dhe prezantim profesional; • Të analizojë dhe vlerësojë mundësitë e zhvillimit të tyre profesional; • Kuptojë dinamika në një vend të punës; • Përdor përvojën e marrë në internship për të reflektuar në raportet ndërmjet jetës akademike dhe tregut të punës; • Vlerësojë se çka i duhet për tu integruar në një ambient të panjohur profesional; • Rrit përgjegjësinë dhe autoniminë e tyre profesionale. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	1	15	15
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	8	5	40
Kontaktet me	1	15	15

mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet ,etj	2	7	14
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
Ligjërata, diskutime, konsultime, punë praktike, ese.			
Metodat e vlerësimit:			
Pjesëmarrja (15%), Projekte (55%), Prezantimi final (30%).			
Literatura:			
H. Frederick Sweitzer and Mary A. King, <i>The Successful Internship</i> (4 th Edition), Brooks/Cole (2013) Barbara Pachter, <i>The Essentials of Business Etiquette</i> , McGraw Hill (2013)			
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Përgatitje për internship – hyrje		
<i>Java e dytë:</i>	Rezymeja		
<i>Java e tretë:</i>	Komunikimi online dhe direkt		
<i>Java e katërt:</i>	Etika		
<i>Java e pestë:</i>	Teknologjitë digjitale		
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerat e hapjes		
<i>Java e shtatë:</i>	Të kuptuarit e vendit të punës		
<i>Java e tetë:</i>	Internship		
<i>Java e nëntë:</i>	Internship		
<i>Java e dhjetë:</i>	Internship		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Internship		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Internship		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Diskutim i projekteve		
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Diskutim i projekteve		
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Reflektim mbi përvojën e internshipit		
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:			
Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i përcjellin të gjitha ligjëratat dhe ushtrimet. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime.			

Kapituj nga Kombinatorika

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Kapituj nga Kombinatorika
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Armend Shabani
Detajet kontaktuese:	armend.shabani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Kursi mbulon disa metoda të kombinatorikës, të shtjelluara në kapituj të ndryshëm. Mes tjerash do të përfshihen metodat e 'sitës', parimi i involucionit dhe metoda e përcaktorëve për numërimin e rrugëve në rrjetë. Do të shqyrtohen aspekte të ndryshme të teorisë së bashkësive pjesërisht të renditura, për shembull teoria e rrjetës, inversioni i Möbius-it në bashkësitë pjesërisht të renditura dhe ndërlidhjet me topologjinë. Do të shqyrtohet numërimi përmes funksioneve simetrike dhe kuazi-simetrike dhe ndërlidhjet me teorinë e përfaqësimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është që kandidatët të familjarizohen me metodat e avansuara kombinatorike në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me strukturat kombinatorike: permutacionet, fjalët, kompozicionet, zbërthimet e bashkësisë, bashkësitë pjesërisht të renditura, funksionet simetrike etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none">- Të përcaktojnë dhe vërtetojnë vetitë e objekteve standarde kombinatorike dhe të vargjeve të numrave.- Të riformulojnë dhe në këtë mënyrë të zgjidhin probleme nga kombinatorika përmes objekteve

	<p>standarde të kombinatorikës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të bëjnë njehsime dhe të vërtetojnë vetitë e serive formale fuqi. - Të ndërtojnë dhe të zgjidhin relacione rekurrente, funksione gjeneruese dhe shprehje eksplicite për vargje të përcaktuara në mënyrë kombinatorike. - Të përdorin inversionin e Mobius-it, parimin e përfshirjes-përrjashtimit dhe metodat e sitës për të zgjidhur probleme të numërimit. - Të përcaktojnë dhe vërtetojnë vetitë e bashkësive pjesërisht të renditura - Të zgjidhin probleme të numërimit përmes numërimit të funksioneve simetrike dhe kuazi-simetrike
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj	2	1	2
Totali			160

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë individuale në projekte/detyra/seminare.

Metodat e vlerësimit:	Punë seminarike: 20%, Detyra/Projekte individuale 20%: Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30%
Literatura	
Literatura bazë:	[1] Bruce Sagan, Combinatorics: The Art of Counting, AMS 2021. [2] Ö. Eğecioğlu, A. M. Garsia, Lessons in Enumerative Combinatorics, Springer, 2021 [3] M. Aigner, A course in Enumeration, 2007
Literatura shtesë:	[4] S. Heubach, T. Mansour, Combinatorics of Compositions and Words, CRC Press, 2010 [5] M. Bóna, Combinatorics of Permutations, CRC Press, 2012

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Elementet themelore të numërimit– pjesa I
Java e dytë:	Elementet themelore të numërimit – pjesa II
Java e tretë:	Numërimi me shenja– pjesa I
Java e katërt:	Numërimi me shenja – pjesa II
Java e pestë:	Numërimi me funksione gjeneruese– pjesa I
Java e gjashtë:	Numërimi me funksione gjeneruese – pjesa II
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë
Java e tetë:	Numërimi me funksione gjeneruese eksponenciale
Java e nëntë:	Numërimi me bashkësi pjesërisht të renditura– pjesa I
Java e dhjetë:	Numërimi me bashkësi pjesërisht të renditura – pjesa II
Java e njëmbëdhjetë:	Numërimi me funksione simetrike – pjesa I
Java e dymbëdhjetë:	Numërimi me funksione simetrike – pjesa II
Java e trembëdhjetë:	Numërimi with me funksioni kuazisimetrike– pjesa I
Java e katërmëdhjetë:	Prezentimet e studentëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët duhet të vijnë me rregull dhe në kohë në ligjërata, ushtrime e provime. Ata duhet t'i kontribuojnë një procesi mësimor konstruktiv dhe t'i ndjekin udhëzimet e instruktorit. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të bisedojnë me kolegë në lidhje me detyrat me kushtin që shënohen emrat e kolegëve me të cilët është diskutuar dhe/ose resurset që janë përdorur. Pandershmeria akademike do të ndëshkohet.

Kapituj nga Teoria e Përfaqësimit

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Kapituj nga Teoria e përfaqësimit		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	II-të		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Qëndrim R. Gashi		
Detajet kontaktuese:	qendrim.gashi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Ky kurs e jep një panoramë të teorisë bazike të përfaqësimit të grupeve, algjebrave të Liut dhe algjebrave asociative, si dhe disa zbatime të kësaj teorie në fusha të tjera të matematikës (teorisë së numrave, gjeometrisë algjebrike, kombinatorikës, etj.) dhe jashtë saj (fizika teorike, mekanika kuantike etj.).		
Qëllimet e lëndës:			
	Qëllimi i kursit është që studentët t'i kuptojnë disa rezultate themelore në teorinë e përfaqësimit të grupeve, algjebrave të Liut dhe algjebrave asociative, dhe t'i përdorin ato qoftë në studime të mëtejme, qoftë për zbatime jashtë matematikës.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të përdor dhe vërtetojë pohimet e rëndësishme për kuiverët, algjebtrat e Liut, përfaqësimin e algjebrave me dimension të fundmë, karakteret; • T'i përdor teoremat e Zhordan-Holderit, Krull-Shmitit, Mashkes dhe Bernsajdit si dhe reciprocitetin e Frobeniusit; • T'i kuptojë përfaqësimet e kuivërve, teoremën e Gabrielit si dhe elemente të teorisë së kategorive; • Të zbatojë në fusha të tjera të matematikës si dhe jashtë matematikës nocionet e mbuluara në këtë kurs dhe të përdor në mënyrë të pavarur literaturën shkencore për studime të pavarura dhe kërkime shkencore. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15

Përgatitja përfundimtare për provim	6	1	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet, etj.	1	15	15
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Pjesëmarrja (5%) Detyrat e shtëpisë (10%) Kollokuiumi i parë (15%) Kollokuiumi i dytë (15%) Projekti (15%) Testi final (40%)		
Literatura:			
	Pavel Etingoff et al., Introduction to Representation Theory, AMS (2011). W. Fulton and J. Harris, Representation Theory: A First Course, Springer (1991). Jean-Pierre Serre, Linear Representations of Finite Groups, Springer (1977).		
Plani i dizajnuar i mësim:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Algjebrat. Përfaqësimet. Kuiverët.		
<i>Java e dytë:</i>	Algjebrat e Liut. Produktet tensoriale.		
<i>Java e tretë:</i>	Përfaqësimet e sl_2 .		
<i>Java e katërt:</i>	Përfaqësimet e algjebrave me dimension të fundmë. Karakteret e përfaqësimeve.		
<i>Java e pestë:</i>	Teoremat e Jordan-Holder dhe Krull-Schmidt. Përfaqësimet e produkteve tensoriale.		
<i>Java e gjashtë:</i>	Përfaqësimet e grupeve të fundme: rezultatet themelore. Teorema e Maschke-s.		
<i>Java e shtatë:</i>	Teorema e Burnside-it.		
<i>Java e tetë:</i>	Reciprociteti i Frobenusit.		
<i>Java e nëntë:</i>	Përfaqësimet e S_n .		
<i>Java e dhjetë:</i>	Dualiteti Schur-Weyl.		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përfaqësimet e $GL_2(F_q)$.		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përfaqësimi i kuiverëve.		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Teorema e Gabrielit.		
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Elemente të teorisë së kategorive: funktorët e përfaqësuar, të adjunguar, abelian dhe ekzakt.		
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Struktura e algjebrave me dimension të fundmë.		
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:			
Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i përcjellin të gjitha ligjëratat, ushtrimet dhe provimet. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të diskutojnë me njëri-tjetrin përdorur emrat e kolegëve me të cilët i kanë diskutuar detyrat si dhe resurset e përdorura.			

Metodologjia e kërkimit shkencor

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN		
Titulli i lëndës:	Metodologjia e kërkimit shkencor		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	7 ECTS		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Armend Shabani		
Detajet kontaktuese:	armend.shabani@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	<p>Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e aftësive hulumtuese dhe shkruese në Shkencën e Matematikës dhe zbatimet e saj. Pjesët kryesore të saj janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Metodot empirike dhe zbatimi i tyre në problemet hulumtuese 2. Konceptet e ndërlidhura me shkencat e tjera 3. Metodologjitë hulumtuese: të mirat dhe të metat e tyre 		
Qëllimet e lëndës:			
	Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me idetë themelore, sfidat, teknikat dhe problemet gjatë hulumtimit shkencor.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti është i aftë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të prezentojë metodologjitë e hulumtimit dhe kërkimit në matematikë dhe zbatimet e saj, - Të kuptojë pikat e forta dhe të dobëta të secilës prej këtyre metodave. - Të zgjedhë metodën/at e përshtatshme për hulumtimet? - Të kryejë hulumtime duke përdorur këto metoda? - Të shkruajë artikuj teknikë/punime kërkimore, duke marrë parasysh kufizimet sociale, ligjore dhe etike. - Të raportojë rezultatet e këtyre hulumtimeve. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30

Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj	2	1	2
Totali			175
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.		
Metodat e vlerësimit:			
	Punë seminarike: 30%, Detyra/Projekte individuale (total: 70%): Detyra/Projekti 1: 35% dhe Detyra/Projekti 2: 35%		
Literatura			
Literatura bazë:			
	<p>[1] John W. Creswell, Research Design. Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches, Fourth Edition. SAGE Publication, 2014.</p> <p>[2] Wayne C. Booth, Gregory G. Colomb, Joseph M. Williams , Joseph Bizup, William T. Fitzgerald, The Craft of Research, Third Edition, The University of Chicago Press, 2008.</p> <p>[3] William Strunk Jr. and E. B. White, The Elements of Style, Forth Edition, Pearson, 1999.</p>		
Literatura shtesë:			
	<p>[1] Christian W. Dawson: Projects in Computing and Information Systems (A Student's Guide). Addison Wesley, 2005.</p> <p>[2] Justin Zobel: Writing for Computer Science. Springer, 2004. Harold Cohen Library, Class No 378.962.Z81.</p>		

	<p>[3] R. Kumar, Research Methodology-A step-by-step guide for beginners, Pearson Education, Singapore, 2005.</p> <p>[4] U. Hustadt, COMP516 - Research Methods in Computer Science (2008-2009), Course notes (https://cgi.csc.liv.ac.uk/~ullrich/COMP516/adm.html).</p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm
<i>Java e dytë:</i>	Çfarë është Hulumtimi?
<i>Java e tretë:</i>	Metodat e hulumtimit
<i>Java e katërt:</i>	Hulumtimi në shkencë kompjuterike
<i>Java e pestë:</i>	Leximi i punimit shkencor
<i>Java e gjashtë:</i>	Rishikim i literaturës
<i>Java e shtatë:</i>	Pranimi i burimeve. Prezantimet
<i>Java e tetë:</i>	Zgjedhja dhe planifikimi i një projekti
<i>Java e nëntë:</i>	Kollokviumi i parë
<i>Java e dhjetë:</i>	Menaxhimi i rrezikut në projektet e shkencave kompjuterike
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Çështje sociale, ligjore dhe etike në shkencë kompjuterike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Aktivitete praktike - I
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Aktivitete praktike - II
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Aktivitete praktike - III
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimet e studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët duhet të vijnë me rregull dhe në kohë në ligjërata, ushtrime e provime. Ata duhet t'i kontribuojnë një procesi mësimor konstruktiv dhe t'i ndjekin udhëzimet e instruktorit. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të bisedojnë me kolegë në lidhje me detyrat me kushtin që shënohen emrat e kolegëve me të cilët është diskutuar dhe/ose resurset që janë përdorur. Pandershmëria akademike do të ndëshkohet.</p>

SYLLABUSI i lëndës: Elemente të teorisë spektrale

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës
Drejtimi	Matematikë
Titulli i lëndës:	Elemente të teorisë spektrale
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II(semestri III)
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Muhib Lohaj
Detajet kontaktuese:	Tel.: (0) 44 220-015
Përshkrimi i lëndës	<p>Në fillim të shpjegohet paraqitja e funksionalëve seskvilinear në hapësirat e Hilbertit. Pastaj operatorët e adjunguar si dhe operatorët pozitiv hermitian. Tutje izometria dhe forma polare e operatorit. Pasi që studenti të ketë fituar këto njohuri mundemi shkallë shkallë të kalojmë në pjeset tjera të materjes. Për të kuptuar me lehtësi spektrin e disa operatorëve do të punojmë disa elemente të teorisë spektrale në algjebtrat e normuara si p.sh. spektri dhe rrezja spektrale e elementit. Pas kësaj me lehtësi mund të kalohet në studimin e spektrit të disa llojeve të operatorëve p.sh. spektri i operatorit unitar, hermitian, normal, kompakt. Pasi të jenë arritur këto objektiva, mund të kalojmë në studimin e operatorëve kompakt, operatorët normalë kompakt dhe vetitë spektrale të tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	Me rëndësi të veçantë për studimin e Teorisë së operatorëve, është që studentet të studiojnë

	<p>elementet e teorisë spektrale në algjebtrat e normuara. Meqë hapësira e operatorëve të kufizuar është rast special i algjebrave të Banach-ut, mund të studiohen spektri dhe llojet e spektrit të disa e operatorëve në hapësirat e Hilbertit si p.sh. spektri i operatorit unitar, hermitian, normal, kompakt, etj. si dhe spektri i operatorit të indukuar në lidhje me spektrin.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të zgjidhë probleme konkrete që lidhen me spektrin e elementit në algjebren e normuar. • Të zgjidhë në mënyrë të pavarur probleme që lidhen me operatorët pozitiv • Të gjejë spektrin e operatorëve hermitian, spektrin e operatorit unitar, normal, kompakt, etj. • Të jetë në gjendje të zgjidhë detyra duke aplikuar teoremën mbi pasqyrimin e spektrit.

Kontributi në ngarkesën e studentit –Semestri II			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata me profesorin	2	15	30
Ushtrime me asistentin	2	15	30
Punë praktike			
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për			10

provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)			3
Projektet, prezantimet, etj			
Totali			152

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Paraqitja e funksionalëve seskvillear në hapësirat e Hilbertit
<i>Java e dytë:</i>	Operatorët e adjunguar. Projektorë
<i>Java e tretë:</i>	Operatorët pozitiv hermitian
<i>Java e katërt:</i>	Izometria e pjeshme. Forma polare e operatorit
<i>Java e pestë:</i>	Algjebrat e normuara. Rrezja spektrale
<i>Java e gjashtë:</i>	Elementet regulare të algjebres së normuar
<i>Java e shtatë:</i>	Operatorët regular
<i>Java e tetë:</i>	Spektri dhe rezolventa e algjebres së Banahut
<i>Java e nëntë:</i>	Spektri i operatorit të kufizuar
<i>Java e dhjetë:</i>	Spektri i operatorit të njëanshem të cvendosjes
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Spektri i operatorit unitar dhe operatorit normal
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Spektri i operatorit të indukuar në lidhje me spektrin e operatorit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Operatorët kompakt në hapësirat e Hilbertit
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Teorema spektrale për operatorët normal kompakt

Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • W. Rudin, <i>Functional Analysis</i>, Mc Fraw-Hill Book Company, New York, 1973, • W. Rudin, <i>Real and complex analysis</i>, Mc

Graw-Hill Book Company, New York, 1973,

- Kurepa S., Funkcionalna analiza, Elementi teorija operatora, Školska knjiga, Zagreb, 1981,
- C. Apostol, L.A. Fialkov, D.A. Herrero and D. Voiculescu, *Approximation of Hilbert space operators, Vol II, Research Notes in Mathematics* 102, Pitman, Boston, 1984,
- R. Zejnullahu, *Analiza funkcionalna*, Prishtinë 1998.

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore		
Titulli i lëndës:	Matematika aktuaristike		
Niveli:	Master- Matematikë me zbatim		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti parë/ Semestri dytë		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	N/A, FShMN		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Behar Baxhaku		
Detajat kontaktuese:	behar.baxhaku@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Në këtë kurs studiohen modelet aktuariale të mbijetesës, sigurimi i jetës përfshirë modelet e shumta të jetës, pastaj modelet e anuitetit kontingjent, llogaritja e primeve të përfitimeve, dhe në fund përfshirja e shpenzimeve në modelet e sigurimeve.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kursit është të rrisë të kuptuarit e studentëve për temat e mbuluara, dhe si qëllim` dytësor është të përgatisë studentët për një karrierë në shkencën aktuariale.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegoj dhe interpretoj efektet e kalimit midis gjendjeve modelet e mbijeteses dhe nderveprimet e tyre; • Përshkruaj disa nga modelet që zbatohen në matematikën aktuale; • llogarit dhe interpretoj funksionet standarde të probabilitetit duke përfshirë probabilitetin e mbijetesës dhe vdekshmërisë; • Shpjegoj variablat e rastit të lidhura me modelet e shumëfishta të jetës; • Interpretton dhe llogarit probabilitetet dhe momentet marginale dhe të kushtëzuara; • Zbatojë nocionet e mbuluara në këtë kurs në shkencën aktuariale dhe kërkime shkencore. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me	1	5	5

mësimdhënës/konsultimet			
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	-	-	-
Totali			110
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, seminare, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokfiume, provimi përfundimtar.		
Metodat e vlerësimit:	Lënda do të vlerësohet mbi bazën e detyrave të shtëpisë 10%; Testi i parë periodik 20%; Testi i dytë periodik 20% si dhe provimi final 50%. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa ndonjë arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët. Për të konkretizuar njohuritë, gjatë seminareve dhe leksioneve do të realizohen një numër i madh ushtrimesh.		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Marcel B. Finan. A Reading of the Theory of Life Contingency Models: A Preparation for Exam MLC/3L (2011) 2. David C.M. Dickson, Mary R Hardy, Howard R. Waters, Actuarial Mathematics for Life Contingent Risk, Cambridge (2019) 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Andrew Leung, Lifetables and Mortality Models, Elsevier (2022) 		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njohje me lëndën. Syllabusi i lëndës
Java e dytë:	Hyrje në teorinë e interesit
Java e tretë:	Modelet aktuariale të mbijetesës
Java e katërt:	Tabelat e jetës
Java e pestë:	Sigurimi i jetës:
Java e gjashtë:	Modelet e pagesave të kushtëzuara
Java e shtatë:	Modelet e anuitetit kontingjent
Java e tetë:	Llogaritja e primeve të përfitimeve

Java e nëntë:	Rezervat e përfitimit
Java e dhjetë:	Modelet konkurruese të rrezikut
Java e njëmbëdhjetë:	Modele të shumta të jetës
Java e dymbëdhjetë:	Modelet konkurruese të rrezikut
Java e trembëdhjetë:	Madelet e tranzicionit
Java e katërbëdhjetë:	Modelet probabilitare
Java e pesëmbëdhjetë:	Aplikimi i modeleve probabilitare

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët me synimin për të arritur sukses të lartë në studime duhet:

1. Të ndjekë rregullisht ligjëratat
2. Të jenë pjesë aktive e ligjëratave përmes pyetjeve, debateve dhe formave të tjera të aktiviteteve ndërvepruese.
3. Të marrin pjesë në testet periodike dhe atë përfundimtar
4. Gjatë periudhës së ligjëratave, ushtrimeve, testeve dhe provimeve janë të detyruar t'i nënshtrohen Kodit të Sjelljes (Në sallën e mësimi studentët duhet të gjenden para fillimit të ligjëratës. Gjatë orës mësimore telefonat celular duhet të jenë të shkyçur etj.)

Titulli i lëndës: Analiza e të dhënave

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore (FSHMN)		
Titulli i lëndës:	Analiza e të dhënave		
Niveli:	MSc		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Viti i parë / Semestri i dytë		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Kreditë ECTS:	6		
Koha / Vendi:	N/A, Departamenti i Matematikës, FSHMN		
Mësimdhënësi:	Dr. Ermir Rogova		
Të dhënat kontaktuese:	ermir.rogova@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi përmban pesë pjesë kryesore, duke filluar me paraprocesimin e të dhënave, që përfshin pjesën më të madhe të kohës gjatë analizës të të dhënave, pastaj vazhdohet me vizualizim, modele parashikuese, analizë të lidhjeve në mes të të dhënave, grupim të të dhënave dhe detektim të anomalive.</p> <p>Parakushtet: Programimi dhe algoritmet, Struktura e të dhënave</p>		
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me konceptet themelore dhe algoritmet e caktuara për secilën pjesë kryesore të lëndës, duke ju dhënë kështu atyre mundësinë e aplikimit të modeleve të analizës të të dhënave në problemet reale.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë të aftë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - manipulojnë me të dhëna që përdoren për analizë; - kuptojnë modelet parashikuese dhe algoritmet e tyre; - gjejnë lidhjet në mes të të dhënave dhe përdorimin e algoritmeve të tyre; - grupojnë të dhënat në bazë të karakteristikave të përbashkëta; - detektojnë shfaqjen e anomalive, dhe në fund - vizualizojnë rezultatet e të gjitha teknikave të përmendura. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Përgatitje për test intermediar	-	-	-
Konsultime me mësimdhënësin	1	15	15

Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	15	1	15
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	15	1	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	4	1	4
Projektet, prezantimet, detyrat, etj.	1	1	1
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...	-	-	-
Total			160

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime laboratorike dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.
Metodat e vlerësimit:	Kuiz në klasë: 10% Detyra/Projekti 1: 10% Detyra/Projekti 2: 10% Provimi periodik: 20% Provimi final: 50%
Literatura primare:	P. Tan, M. Steinbach, A. Karpatne, Y. Kumar, Introduction to data mining (2nd edition), Pearson 2018
Literatura shtesë:	J. Han, Data mining: Concepts and techniques, Morgan Kaufman, 2012

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Ligjërata: Njohje me lëndën / Shqyrtimi i syllabusit Lexim: Syllabusi i lëndës
Java 2:	Ligjërata: Hyrje, historiku dhe bazat e analizës të të dhënave Lexim: Literatura primare, Kapitulli 1 Seminare/Projekte: Përcaktimi i projekteve të para
Java 3:	Ligjërata: Le të njohim të dhënat Lexim: Literatura primare, Kapitulli 2
Java 4:	Ligjërata: Paraprocesimi i të dhënave Lexim: Literatura shtesë, Kapitulli 3
Java 5:	Ligjërata: Klasifikimi – teknika fillestare Lexim: Literatura primare, Kapitulli 3
Java 6:	Ligjërata: Klasifikimi – teknika alternative Lexim: Literatura primare, Kapitulli 4 Seminare/Projekte: Prezantim i projekteve të para
Java 7:	Ligjërata: Klasifikimi – teknika alternative Lexim: Literatura primare, Kapitulli 4
Java 8:	Ligjërata: Klasifikimi – teknika alternative Lexim: Literatura primare, Kapitulli 4
Java 9:	Ligjërata: Provimi periodik Lexim: Literatura primare, Kapitulli
Java 10:	Ligjërata: Analiza e asociacioneve – konceptet themelore Lexim: Literatura primare, Kapitulli 5
Java 11:	Ligjërata: Analiza e asociacioneve – konceptet themelore Lexim: Literatura primare, Kapitulli 5

Java 12:	Ligjëratë: Analiza e klusterëve – koncepte themelore
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
Java 13: Studentët duhet të vijnë me rregull dhe në kohë në ligjëratë, ushtrimet e provime. Ata duhet t'i kontribuojnë një procesi mësimor konstruktiv dhe t'i ndjekin udhëzimet e instruktorit. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të bisedojnë me kolegë në lidhje me detyrat me kushtin që shënohen emrat e kolegëve me të cilët është diskutuar dhe/ose resurset që janë përdorur. Pandershmeria akademike do të ndëshkohet ashpër. Vijuoshmeria e ligjëratave dhe ushtrimeve laboratorike është obligative.	Ligjëratë: Analiza e klusterëve – koncepte themelore Lexim: Literatura primare, Kapitulli 7 Ligjëratë: Detektimi i anomalive Lexim: Literatura primare, Kapitulli 9 Ligjëratë: Trendet dhe hulumtimi Lexim: Literatura sintese, Kapitulli 13 Seminare/Projekte: Prezantimi i projekteve të dyta

SYLLABUSI i lëndës: Analiza Matematike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Departamenti i matematikes, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Analiza Matematike
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E mërkure, 9.45 – 12.15, Laboratori V.
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Naim Braha
Detajet kontaktuese:	nbraha@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs jepen kuptimet themelore nga hapësirat metrike, teoria e masës dhe integrimi sipas Lebegut, hapësirat e normuara, hapësirat e Hilbertit, transformimet lineare, hapësirat e Banachut, hapësirat lokalisht konvekse, dualiteti, operatorët në hapësirat e Banachut (tri teoremat bazike, Teorema mbi grafën e hapur, Hahn-Banach, Banach-Steinhaus).
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none">• njohuritë mbi kuptimet e hapësirave metrike,• integralin e Riman Stieltesit,• masës dhe integralit të Lebegut,• hapësirat e normuara,• hapësirat e Hilbertit,• hapësirat e Banachut,• hapësirat lokalisht konvekse,• hapësirat duale,• operatorët në hapësirat e Hilbertit dhe të Banachut,• teorema Hahn-Banachut, teorema e Grafit të mbyllur, Teorema e Banach-Steinhaus-it
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studenti duhet që të: <ul style="list-style-type: none">• të dije kuptimet e hapësirave metrike,• të dije kuptimin e integralit të Riman Stieltesit,• të dije masën dhe integralit të Lebegut,• të dije mbi hapësirat e normuara, ato Hilbertiane, hapësirat e Banachut, hapësirat

	lokalisht konvekse, hapësirat duale, <ul style="list-style-type: none"> • ti dije mbi operatoret lineare ne hapësirat e Hilbertit dhe te Banachut, • te dije teoremat fundamentale, Hahn-Banachut, teorema e Grafrit te mbyllur, Teorema e Banach-Steinhaus-it. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	4	6	24
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim			30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			9
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			213
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime gjatë ligjëratave, konsultime në grupe apo individuale, test eperiodeke, provimi final.		
Metodat e vlerësimit:	Testi i pare periodik (kollokuium): 45% Testi idyte periodik (kollokuium): 45% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti ne mesim 10% Total: 100% Nese studenti nuk merre pjese ne teste periodike i nenshkrohet testit final i cili ka 90% te pikeve te teresise se testit, dhe 10% jana nga aktiviteti dhe vijueshmeria.		

Literatura	
Literatura bazë:	John B. Conway , A Course in Abstract Analysis, Ams, 2012 H.L. Royden and P.M. Fitzpatrick, Real Analysis, fourth editon,2010, Pearson Education Boules, Adel N. Fundamentals of mathematical analysis. <i>Oxford University Press, Oxford, 2021.</i> xviii+462 pp. ISBN: 978-0-19-886879-8; 978-0-19-886878-1
Literatura shtesë:	E. Kreyszig, <i>Introductory Functional Analysis with Applications</i> , John Wiley & Sons, 1978 W. Rudin, <i>Functional Analysis</i> , McGraw-Hill, 1978 <i>John Conway, A course in functional analysis, Second edition, Springer, 1990.</i> <i>Edwin Hewitt and Karl R. Stromberg, Real and Abstract Analysis, Springer , 1975.</i> <i>Robert Magnus, Metric Spaces, Springer, 2021</i>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Numrat real, bashkesite , vargjet dhe funksionet
Java e dytë:	Njohuritë mbi kuptimet e hapësirave metrike
Java e tretë:	Konvergjencia dhe kompaktesia ne hapesirat metrike
Java e katërt:	Hapesirat topologjike, vetite e pergjithshme
Java e pestë:	Integrali i Riman Stieltesit
Java e gjashtë:	Masa e Lebegut
Java e shtatë:	Funksionet e matshme dhe pohimet e tyre
Java e tetë:	Integrali i Lebegut
Java e nëntë:	Hapesirat e normuara
Java e dhjetë:	Hapesirat e Hilbertit
Java e njëmbëdhjetë:	Hapesirat e Banachut
Java e dymbëdhjetë:	Hapesirat lokalisht konvekse
Java e trembëdhjetë:	Hapesirat duale
Java e katërmëdhjetë:	Operatoret ne hapesirat e Hilbertit dhe Banachut
Java e pesëmbëdhjetë:	Teorema e Hahn-Banachut, Teorema e grafit te mbyllur, Teorema e Banach –Steinhaus-it

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjëratat e ushtrimeve obligueshëm (me tri e me shumë mungesa të paarsyeshme, studenti/ja e ndegjone lenden përseri vitin tjetër). Në sallën e mësimit studentët duhet të gjenden para fillimit të ligjëratës. Respektimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe rregullave tjera të Universitetit e Fakultetit. Po ashtu, përdorimi i celularëve apo mjeteve tjera elektronike që pengojnë procesin e mësimit, është i ndaluar.

SYLLABUSI i lëndës: Analizë komplekse

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Drejtimi	Matematikë		
Titulli i lëndës:	Analizë komplekse		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Elver Bajrami		
Detajet kontaktuese:	Elver.bajrami@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs ofron vazhdimësi të kursit në nivelit bachelor me theks të veçantë në kuptimet më të avancuara të analizës komplekse. Këtu do të shtjellohen kryesisht: zgjerimi analitik i funksioneve komplekse, funksionet me shumë variabla komplekse, funksionet subharmonike dhe log subharmonike, faktorizimin e funksioneve të plota dhe meromorfe, principi i modulit maksimal, disa zbatime të funksionit Gama dhe Zeta të Rimanit - zbatimi i tij tek teorema themelore e numrave të thjeshtë.		
Qëllimet e lëndës:	Studentët do të zgjerojnë kuptimet bazike të analizës komplekse dhe t'i aplikojnë ato në kurset speciale të semestrit në vazhdim		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kursit, studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • dijë të zbatojë zgjerimin analitik të një funksioni me variabël kompleks; • përshkruajë kuptimet e funksioneve me shumë ndryshore dhe faktorizimin e tyre; • identifikojë dhe klasifikojë vetitë bazike të funksionit Zeta të Rimanit; • zbatojë teknikat e reja të fituara për t'i zbatuar në vërtetimin e teoremës themelore të numrave të thjeshtë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit – Semestri II			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6

Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			155

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Syllabusi i lëndës, hyrje
<i>Java e dytë:</i>	Koncepti i zgjerimit analitik të funksioneve
<i>Java e tretë:</i>	Zgjerimi analitik i zhdrejtë dhe sipas lakorës
<i>Java e katërt:</i>	Parimi i simetrisë
<i>Java e pestë:</i>	Parimi i Shvarcit
Pjesëmarrja në leksione, ushtrime dhe provime është e detyrueshme. Studentët pritët të kontribuojnë me diskutimet dhe detyrat e tyre të shtëpisë. Ata inkurajohen të marrin pjesë në orët e punës. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por nxënësit inkurajohen të diskutojnë me njëri-tjetrin për sa kohë që u japin kredi të gjithë kontribuesve në një zgjidhje. Ndershmëria akademike është e detyrueshme.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FShMN, Departamenti i Matematikës
Titulli i lëndës:	Kriptografia
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Z
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Kajta H. Bllaca
Detajet kontaktuese:	kajta.h.bllaca@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	
	Kriptografia është një mjet i domosdoshëm që përdoret për të mbrojtur informacionin në sistemet kompjuterike. Kriptografia rrjedh nga fjala greke <i>kryptos</i> , që do të thotë <i>i fshehur</i> dhe <i>graphein</i> që do të thotë <i>të shkruash</i> . Shembuj të temave që trajtohen në këtë kurs janë: Disa tema nga Teoria elementare e numrave (Pjesëtimi dhe algoritmi i Euklidit, Kongruencat, fushat e fundme dhe mbetjet kuadratike) dhe temat nga Kriptografia si: Nga shifrimi i Cezarit deri te Kriptografia me çelës publik.
Qëllimet e lëndës:	
	Qëllimi i këtij kursi është të njohë studentin me temat aritmetike, të lashta dhe shumë moderne, të cilat kanë qenë në qendër të interesit në aplikime, veçanërisht në kriptografi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	Pas përfundimit të kursit pritet që studenti <ul style="list-style-type: none"> • Të njohë zhvillimin e kriptografisë, • Të njohë se si funksionojnë sistemet kriptografike, • Të kuptojë pse sistemet kriptografike janë të sigurta. • Të kuptoj rëndësinë e sistemet kriptografike; • Problemet e zgjidhura të dijë t'i zbatojë në zgjidhjen e problemeve të reja, dhe në fund të krijoj ide dhe metoda për ta rritur shkallën e abstrakcionit të problemeve të kriptografisë.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokuiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	5	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	1	15	15
Projektet, prezantimet, etj.	-	-	-
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, detyra shtëpie, konsultime, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Kollokuiumet, Detyrat e shtëpisë dhe puna seminarike, Aktiviteti në mësim, Vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Kollokuiumet Dy kollokuiume, secili me pikë maksimale 60; provimet janë me shkrim.</p> <p>Detyrat e shtëpisë dhe puna seminarike Do të jipen dy detyra të shtëpisë (të cilat do të vlerësohen), një në periudhën para kollokuiumit të parë dhe një para kollokuiumit të dytë. Do të jenë detyra të tipit të njëjtë sikur ato që do të bëhen në ushtrime.</p> <p>Afati i fundit për dorëzim do të jetë një javë. Numri maksimal i pikëve për secilën detyrë është 10 pikë. Detyrat nuk janë të obligueshme. Ata që nuk i zgjedhin do të kenë zero pikë.</p> <p>Aktiviteti në klasë Gjatë ushtrimeve rregullisht, dhe në ligjërata herë</p>		

	<p>pas here do të jipen detyra për zgjidhje në mënyrë të pavarur. Studentët të cilët janë të suksesshëm në zgjidhjen e këtyre detyrave, marrin nga 5 pikë për çdo detyrë.</p> <p>Numri maksimal i pikëve që mund të mbliidhen në këtë pjesë është 20. Me 10 pikë të mbledhura, studentët do të kenë mundësinë e lirimit nga vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Provimi përfundimtar</p> <p>Provimi është me shkrim; verifikohet të kuptuarit e përmbajtjes së trajtuar në ligjërata.</p> <p>Kushti për hyrje në provimin përfundimtar, është një total prej të paktën 50 pikë të mbledhura në dy kollokuimet, detyrat dhe aktivitetet në klasë.</p> <p>Numri maksimal i pikëve të mundshme për të marrë në provimin përfundimtar është 40 pikë.</p> <p>Studentët të cilët përmes aktiviteteve në klasë mbledhin të paktën 10 pikë nuk e kanë të detyrueshme të hyjnë në provim përfundimtar, por mund të marrin notën bazuar në dy kollokuimet periodike, detyrat dhe aktiviteti në klasë.</p> <p>Provimi përmirësues</p> <p>Përmisimi i pikëve mund të bëhet më së shumti në njërin nga kollokuimet ose provimin përfundimtar. Pas kollokuimit të dytë studentët mund të zgjedhin në cilin kollokuimit dëshirojnë të përmisojnë pikët.</p> <p>Studentët të cilët nuk janë të kënaqur me rezultatin e vlerësimit përfundimtar dhe të cilët nuk i janë nënshtruar kollokuimit përmirësues si më lartë mund të hyjnë në test përmirësues të provimit përfundimtar. Ky test do të jetë në të njëjtën kohë të provimit përfundimtar për studentët të cilët kanë kërkuar test përmisues në njërin nga dy kollokuimet.</p> <p>Nota përfundimtare</p> <p>Do të mbliidhen pikët nga kollokuimi i parë (max 60 pikë), kollokuimi i dytë (max 60 pikë), zgjidhjen e detyrave të shtëpisë (max 20 pikë), aktiviteti në klasë (max 20 pikë) dhe provimi përfundimtar (max 40 pikë). (Studentët të cilët janë të liruar nga provimi përfundimtar, do ju mbliidhen pikët vetëm nga katër komponentat e para.</p> <p>Nota:</p> <p>> 90% nota 10;</p> <p>> 80% nota 9;</p>
--	--

	<p>> 70% nota 8; > 60% nota 7; >= 45% nota 6.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	[1] Neal Koblitz, A Course in Number Theory and Cryptography-Springer US (1987).
Literatura shtesë:	[2] Thomas Baigneres, Pascal Junod, Yi Lu, Jean Monnerat, Serge Vaudenay, A Classical Introduction to Cryptography, Exercise Book-Springer (2006). [3] David M. Burton, Elementary number theory, McGraw-Hill (2002).
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Plotpjesëtueshmëria. Algoritmi i pjesëtueshmërisë. Numrat e thjeshtë. Teorema Fundamentale në Aritmetikë
<i>Java e dytë:</i>	Kongruencat lineare. Sistemet e kongruencave lineare. Teorema kineze e mbetjeve. Testimi i plotpjesëtueshmërisë
<i>Java e tretë:</i>	Disa zbatime të faktorizimit
<i>Java e katërt:</i>	Fushat e fundme
<i>Java e pestë:</i>	Mbetjet kuadratike
<i>Java e gjashtë:</i>	Ligji i reciprocitetit kuadratik
<i>Java e shtatë:</i>	Disa kriptosisteme të thjeshta
<i>Java e tetë:</i>	Shifrimi me matrica
<i>Java e nëntë:</i>	Çelësi publik
<i>Java e dhjetë:</i>	RSA
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Discrete log dhe Knapsack
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Pseudo numrat e thjeshtë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Metoda rho
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Faktorizimi i Fermas
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Metoda e thyesave të vazhdueshme

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimit, do të jetë i ndaluar.</p>

Vijueshmëria e rregullt është obligative.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i shkencave matematike - natyrore
Titulli i lëndës:	Makroekonomia e avancuar
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet kryesore makroekonomike, funksionimin e ekonomisë nacionale dhe ndërkombëtare dhe politikat ekonomike në zbatim. Në pjesën e parë trajtohen çështjet bazike të makroekonomisë duke përfshirë nocionin e makroekonomisë, ekonominë kombëtare, fazën e tranzicionit dhe politikën zhvillimore makroekonomike në Kosovë pas vitit 1999. Në këtë pjesë trajtohen edhe madhësitë globale makroekonomike: Bruto Produkti Vendor (BPV), Bruto Produkti Kombëtar (BPK), tregu, oferta dhe kërkesa agregate, lakorja e ofertës agregate dhe kërkesës agregate, ekuilibri ekonomik.</p> <p>Trajtimi i këtyre temave mundëson që në pjesë tjera të kursit të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me inflacionin dhe deflacionin, llojet dhe shkaqet e inflacionit, lakorja e Filipsit, Kuptimi i papunësisë, llojet e papunësisë, efektet e papunësisë dhe masat për zgjidhjen e papunësisë. Në këtë kurs trajtohet edhe paraja dhe funksionet e parasë, funksionimi i sistemit bankar, politika dhe sistemi fiskal, buxheti i shtetit, marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare.</p> <p>Konsumi, kursimet dhe investimet, multiplikatori ku përfshihet: multiplikatori i shpenzimeve, multiplikatori i politikës fiskale (multiplikatori i shpenzimeve qeveritare, multiplikatori i taksave dhe multiplikatori i ekonomisë së hapur).</p>

<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Përgatitja dhe aftësimi i studenteve për të kuptuar makroekonomine dhe konceptet kryesore makroekonomike, objektivat kryesore makroekonomike, mjetet politike për realizimin e objektivave makroekonomike, të mesoj student se çfare është inflacioni, deflacioni, desinflacioni dhe lakroja e Philipsit. Poashtu, student duhet të mesoj për GDP e GNP si dy koncepte kryesore makroekonomike, Papunesine dhe llojet e papunesise si dhe politikat sociale, të dije se si hartohen politikat monetare dhe ato fiskale, Banka Qndrore dhe roli i saj në ekonomi, Paraja dhe funksionet e parase, Multiplikatorët ekonomikë dhe llojet e tyre, si dhe për marrëdhënjet ekonomike ndërkombëtare dhe tendencat e të gjitha ekonomive për të qene pjesë integrale e ekonomise globale...</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vështrojnë dhe analizojnë politikat zhvillimore dhe ecuritë konkrete ekonomike. - Dije t'i shqyrtojnë dhe analizojnë treguesit global makroekonomik si indikatorët më relevant që shprehin nivelin e zhvillimit ekonomik në nivel të ekonomisë kombëtare dhe ndërkombëtare; - Kuptojnë postulatet kryesore të ekonomisë së tregut, ofertën dhe kërkesën, si dhe ndikimin e tyre në afarizmin dhe rrjedhat ekonomik në shkallë vendi; - Kuptojnë peshën ekonomike dhe sociale të papunësisë dhe marrjen e masave konkrete për zgjedhjen e saj. - Kuptojnë veprimin e inflacionit në rrjedhat ekonomike dhe në standardin jetësor të popullsisë dhe masat për evitimin apo zbutjen e tij. - Dije të zbatojnë politikën fiskale, politikën Monetare - kreditore dhe politikën e tregtisë së jashtme në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.
<p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e</p>	

të nxënit të studentit)			
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Kolokiume, seminare	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			42
Ngarkesa totale orë			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligjërata, ▪ ushtrime, ▪ punë individuale, ▪ punë eksperimentale, ▪ punime seminari, ▪ kolokiume, ▪ ese, ▪ punë në terren, ▪ punë në grupe etj. 		
Metodat e vlerësimit:			
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Provimi mbahet me test ▪ Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim: 10% ▪ Puna praktike dhe seminarët 20 % ▪ Testet intermediere (semestrare dhe gjysmësemestrare) (2) 30% ▪ Provimi final 40% 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, “Hyrje në Ekonomi”, Shtëpia Botuese “PEGI”, Tiranë, 2003. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dornbush & Fischer, Makroekonomia, Tirane, 2010 2. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi me planprogramin mësimor të lëndës dhe obligimet e dyanshme profesor – student
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje ne makroekonomi, Konceptet kryesore makroekonomike
<i>Java e tretë:</i>	Kerkesa Agregate (AD), Oferta Agregate (AS) dhe Ekuilibri Makroekonomik
<i>Java e katërt:</i>	Treguesit kryesor makroekonomik (GDP e GNP)
<i>Java e pestë:</i>	Papunesia, kuptimi, llojet, efektet dhe masat për zgjidhjen e papunësisë
<i>Java e gjashtë:</i>	Iflacioni, Deflacioni dhe Desinflacioni, Lakorja e Philipsit
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I-rë Mes-semestral
<i>Java e tetë:</i>	Paraja dhe funksionet e parasë
<i>Java e nëntë:</i>	Politikat Monetare dhe Kreditore, instrument kryesor per realizimin e objektivave makroekonomike
<i>Java e dhjetë:</i>	Sistemi bankar dhe roli e funksionet e Bankes Qendrore
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Politikat Fiskale, si instrument kryesor per realizimin e objektivave makroekonomike, Sistemi fiskal dhe nocioni i buxhetit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Multiplikatori, llojet e tij
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Konsumi dhe Kursimi
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Marredhenjet ekonomike nderkombetare
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi II-të Mes-semestral

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet dhe të marrin dhe librat e ushtrimeve. Studentët duhet të vijnë me kohë në mësim, të ruajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog përmes shpjegimit interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Rekomanohet që gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve studentët të q'kyqin telefonat celularë.

SYLLABUSI i lëndës: Matematikë financiare

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Drejtimi	Matematikë		
Titulli i lëndës:	Matematikë financiare		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Elver Bajrami		
Detajet kontaktuese:	Elver.bajrami@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs do të shërben kryesisht për të vlerësuar sigurinë financiare dhe për të bërë vlerësime të rrezikut të investimit. Temat përfshijnë vlerën në kohë të parasë, anuitetet dhe flukset monetare, huat, obligacionet, flukset e përgjithshme të parasë dhe portofolet, imunizimi, shkëmbimet dhe strategjitë e mbrojtjes dhe investimit. Po ashtu këtu do të tregohet zbatimi i gjerë i derivateve siç është rasti tek modelet Black-Scholes si dhe përdorimi i programeve të ndryshme kompjuterike për bere llogaritjet.		
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim që studenti të kuptojë se si të përdoren modelet matematikore për probleme të ndryshme financiare dhe aktuariale.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përshkruajnë disa nga modelet që zbatohen në matematikën financiare, ➤ Identifikojnë përdorimin e formulave adekuate në problemet e caktuara, ➤ Zbatojnë njohuritë e fituara në modele tek vlerësimi i rrezikut, ➤ Hulumtojnë modele specifike përmes ekuacioneve diferenciale në matematikën financiare. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit – Semestri II			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	10	1	10

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			155

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Syllabusi dhe hyrje ne matematikën financiare
<i>Java e dytë:</i>	Vlera në kohë parasë
<i>Java e tretë:</i>	Anuitetet dhe flukset monetare
<i>Java e katërt:</i>	Huat
<i>Java e pestë:</i>	Obligacionet
<i>Java e gjashtë:</i>	Flukset e përgjithshme të parasë dhe portofolet
<i>Java e shtatë:</i>	Imunizimi
<i>Java e tetë:</i>	Shkëmbimet dhe strategjitë e mbrojtjes dhe investimit
<i>Java e nëntë:</i>	Modeli i çmimeve te asetëve
<i>Java e dhjetë:</i>	Lema e Itos
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Problemi Black-Scholes
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Analiza Black-Scholes
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Black-Scholes formula
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kufijtë dhe kushtet finale të Black-Scholes modelit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Programe aplikative të zbatimit të matematikës financiare
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. P. Wilmott, <i>The Mathematics of Financial Derivatives</i>, Cambridge University, 2012. 2. Robert L. McDonald, <i>Derivatives Markets (3rd Edition) (Pearson Series in Finance)</i> 3rd Edition Prentice Hall; 3 edition (September 6, 2012). 3. Ioannis Karatzas, Steven E. Shreve, <i>Methods of Mathematical Finance</i>, Springer, 1998.

Formular për SYLLABUS të lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti I shkencave matematike natyrore
Titulli i lëndës:	Mikroekonomia
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
E-mail adresa:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me bazat e teorisë mikroekonomike, si degë e ekonomisë. Përqendrimi do të jetë mbi zgjedhjet dhe vendimet të cilat i marrin individët dhe firmat në kushte të resurseve të kufizuara. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet çështjeve si vijon: Kufiri i mundësive të prodhimit, kostot oportune, pamjaftueshmëria dhe efikasiteti; Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut; Elasticiteti i kërkesës dhe i ofertës; Sjellja konsumatore; Firma dhe objektivat e saj; Teoria e prodhimit dhe produktit marginal; Kostoja e prodhimit; Konkurrenca e plotë; Monopoli; Format tjera të konkurrencës jo të plotë: Konkurrenca monopolistike dhe Oligopoli; Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit; Sektori publik.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none">• të njoftojë studentët me konceptet bazë mikroekonomike;• të nxit të kuptuarit e vendim-marrjes ekonomike dhe faktorëve lidhur me këtë, si analiza marginale dhe kostot oportune;• të kuptojnë natyrën dhe funksionimin e tregut të produkteve;• të kuptojnë natyrën dhe funksionimin e tregut të faktorëve;• të mësojnë lidhur me “dështimet” e tregut dhe përse shteti ndërhyr në jetën ekonomike;• të mësohen se si të ndërtojnë, të emërtojnë dhe të interpretojnë grafikët dhe diagramet si dhe të dhënat, për të përshkruar apo shpjeguar konceptet ekonomike;• të njihen me „mënyrën ekonomike të të

	<p>menduarit.</p> <ul style="list-style-type: none"> të aftësojë studentët për aplikimin praktik të njohurive teorike të arritura.
<p>të nxënies:</p> <p>Rezultatet e pritura</p>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> interpretojnë kuptimin e koncepteve ekonomike si pamjaftueshmëria, kostoja oportune dhe analiza margjinale; kuptojnë rëndësinë dhe rolin e çmimeve në ekonominë e tregut; përdorin konceptin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës për vlerësimin kuantitativ të situatave ekonomike; kuptojnë kostot e prodhimit të firmës, të prezantojnë këto kosto në formë të lakoreve (kurbave) dhe t'i komentojnë ato; shpjegojnë dhe të prezantojnë grafikisht se si firmat marrin vendime në përcaktimin e çmimeve apo sasisë së prodhimit, në secilën prej strukturave të tregut; të shpjegojnë “dështimin” e tregut dhe rolin e qeverisë; të dëshmojnë aftësinë e ofrimit të zgjidhjeve për problemet e ndryshme ekonomike.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Kolokiume, seminare	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			57
Ngarkesa totale orë			125

Metodat e vlerësimit:		<i>Në përputhje me statutin e UP-së 'Hasan Prishtina'</i>
Literatura		
Literatura bazë:		
	Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, "Hyrje në Ekonomi", Shtëpia Botuese "PEGI", Tiranë, 2003.	
Literatura shtesë:		
	John Sloman, "Economics", fifth edition, 2003. Pindyck & Rubinfeld (2009) Microeconomics. 7th edition. Prentice Hall. William Boyes & Michael Melvi, "Microeconomics", fifth edition, 2002. "Parimet e Mikroekonomisë" Ramiz Livoreka 2012 Botimi i parë, Paul A. Samuelson & William D. Nordhaus, "Economics", Seventeenth Edition, 2001. Artikuj nga interneti, revistat dhe shtypi.	
Plani i detajuar i mësimet		
Java	Temat	
Java 1:	Një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën ekonomike <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptimi i ekonomiksit ▪ Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune ▪ Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut ▪ Përse është e nevojshme njohja e Ekonomiksit ▪ Metodologjia e shkencës ekonomike 	
Java 2:	Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesa dhe kurba e kërkesës 	

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Oferta dhe kurba e ofertës ▪ Ekuilibri i tregut dhe Disekuilibri
Java 3:	Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut (vazhdim) ▪ Ekuilibri i tregut dhe Disekuilibri
Java 4:	Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës <ul style="list-style-type: none"> ▪ Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin ▪ Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin ▪ Lloje të tjera të elasticitetit
Java 5:	Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zgjedhja racionale dhe vendimet e konsumatorit ▪ Dobia marxhinale dhe kërkesa e konsumatorit Zgjedhja konsumatore dhe ligji i kërkesës
Java 6:	Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa (vazhdim) <ul style="list-style-type: none"> ▪ Analiza ordinaliste e zgjedhjes konsumatore
Java 7:	Firma dhe objektivat e saj <ul style="list-style-type: none"> ▪ Llojet e firmave ▪ Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat ▪ Kontabiliteti i firmës. Bilanci dhe pasqyra e rezultatit financiar.
Java 8:	Teoria e prodhimit dhe produktit marxhinal <ul style="list-style-type: none"> ▪ Funkzioni i prodhimit në periudha afatshkurtra ▪ Ligji i të ardhurave zbritëse ▪ Të ardhurat e shkallës, faktori kohë dhe ndryshimet në teknologji ▪ Funkzioni i prodhimit në periudha afatgjata
Java 9:	Kostoja <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kostot në periudha afatshkurtra ▪ Kostoja oportune ▪ Kostoja në periudha afatgjata
Java 10:	Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Tiparet e tregut konkurrencial dhe kurba e kërkesës së firmës.
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër
Java 11:	Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sjellja e firmës dhe e degës në periudha afatgjata ▪ Konkurrenca e plotë dhe efienca ekonomike
Java 12:	Monopoli <ul style="list-style-type: none"> ▪ Monopoli dhe tiparet e tij.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kurba e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në firmën monopol ▪ Efiçenca në kushtet e monopolit dhe kritika e tij <ul style="list-style-type: none"> ▪ Diskriminimi i çmimeve në kushtet e monopolit. ▪ Politikat shtetërore për kontrollin e monopolit.
Java 13:	<p>Forma të tjera të konkurrencës jo të plotë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Tiparet e konkurrencës monopolistike ▪ Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencë monopolistike <ul style="list-style-type: none"> ▪ Oligopoli, llojet dhe baza e ekzistencës së tij ▪ Modele të oligopolit.
Java 14:	<p>Shpërndarja e të ardhurave dhe tregu i faktorëve të prodhimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave ▪ Paga si çmim i faktorit punë ▪ Renta si çmim i tokës ▪ Interesi si çmim i kapitalit
Java 15:	<p>Sektori publik</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi ▪ Sektori publik dhe përmasat e tij ▪ Financimi i sektorit publik ▪ Zgjedhja publike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Modelim matematikor dhe optimizim
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I, semestri II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	N/A
Mësimdhënësi i lëndës:	Ramadan Limani
Detajet kontaktuese:	ramadan.limani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs paraqet një hyrje në Modelimin matematikor dhe optimizim dhe u dedikohet studentëve të cilët janë të interesuar për zgjerimin e njohurive rreth aplikimit të matematikës për zgjidhjen e disa problemeve që kanë të bëjnë me jetën reale. Ky kurs përmban disa tema (njësi) nga modelimi matematikor, të cilat përdorin aparate të ndryshme matematikore si (metoda elementare, metoda grafike, metoda e ekuacioneve të diferencës, metoda e katrorëve më të vegjël, metoda e shumëzuesve të Lagrange-it, EDZ dhe disa tipe elementare të EDP). Ky kurs po ashtu përmban edhe tema të ndryshme nga programimi jolinear (programimi kuadratik, programimi konik), të cilat përdoren për të gjetur zgjidhjen optimale (max ose min) të një funksioni që është modeluar nga një problem nga jeta reale, p.sh. nga ekonomia, biznesi, financa, etj. Vlerat ekstreme të funksioneve me dy apo më shumë variabla dhe zbatimet e tyre, po ashtu janë të përfshira në këtë kurs. Po ashtu, në kuadër të këtij kursi janë edhe disa probleme të cilat modelohen matematikisht duke përdorur EDZ dhe EDP si p.sh. problemi i transportit, problemi i rrjedhës së trafikut, ekuacioni i nxehtësisë si dhe ekuacioni i valëve.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i këtij kursi është njohja e studentëve me disa teknika dhe algoritme të cilat studentët mund t'i përdorin për ndërtimin e një modeli matematikor për të gjetur zgjidhjen optimale të një problemi nga jeta reale, si p.sh. nga: matematika, fizika, ekonomia, financa, biznesi, biologjia, etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtuar një model matematikor të përshtatshëm, i cili e përkshkruan matematikisht

	<p>një problem të dhënë nga: matematika, fizika, ekonomia, financa, biznesi, biologjia, etj. si dhe ju mundëson atyre për të gjetur zgjidhjen optimale (max ose min) të atij problemi.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbatuar një metodë të përshtatshme nga modelimi matematikor për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga: matematika, fizika, ekonomia, financa, biznesi, biologjia, etj. ➤ Përdorë aparate të ndryshme matematikore nga funksionet me shumë ndryshore dhe EDZ e EDP për të zgjidhur probleme të ndryshme nga matematika, fizika, ekonomia dhe atyre që dalin nga jeta reale. ➤ Zbatuar në mënyrë efektive programimin jolinear për të modeluar dhe pastaj zgjidhur probleme të ndryshme nga: ekonomia, financa, biznesi, inxhinieria, biologjia, etj. ➤ Zhvilluar edhe më tej qasjen analitike ndaj problemeve me të cilat ata mund të hasin në të ardhmen dhe gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. ➤ Shprehen rrjedhshëm, gojarisht dhe me shkrim, gjatë formulimit dhe interpretimit të përkufizimeve, shembujve, teoremave dhe pohimeve të ndryshme të spjeguar në këtë kurs.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuime, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim			8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			4
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			136

Metodologjia e mësimdhënies:															
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.														
Metodat e vlerësimit:															
	<p>Vijueshmëria e rregullt: 10%; testi I: 20%; testi II 20%; (provimi me shkrim 50%); provimi përfundimtar: 50%; gjithsej 100%. Notimi përfundimtar do të bëhet sipas tabelës:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Arritshmëria (%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0-49</td> <td>5 (nuk kalon)</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>70-79</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>80-89</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>90-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nëse studenti nuk e kalon provimin me dy testet e organizuara gjatë semestrit, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim dhe provimit me gojë. Provimi me shkrim është eliminues. Në këtë rast provimi me shkrim peshon 40%, provimi me gojë 50% dhe vijueshmëria 10%.</p>	Arritshmëria (%)	Nota	0-49	5 (nuk kalon)	50-59	6 (gjashtë)	60-69	7 (shtatë)	70-79	8 (tetë)	80-89	9 (nëntë)	90-100	10 (dhjetë)
Arritshmëria (%)	Nota														
0-49	5 (nuk kalon)														
50-59	6 (gjashtë)														
60-69	7 (shtatë)														
70-79	8 (tetë)														
80-89	9 (nëntë)														
90-100	10 (dhjetë)														
Literatura															
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Edward A. Benger: An Introduction to Mathematical Modeling, University of California, 1978.</i> 2. <i>Wenyu Sun, Ya-Xiang Yuan: Optimization Theory and Methods, 2006.</i> 3. <i>Dimitri P. Bertseks: Non-Linear Programming, 2004.</i> 4. <i>David G. Luenberger, Yinue Ye: Linear and Non-Linear Programming, 2007.</i> 5. <i>Gerald B. Folland: Introduction to Partial Differential Equations, 1995.</i> 														
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Edward T. Dowling, PhD: Mathematical methods for busines and economics, Schaum's outline series, Mc-Graw Hill, 2009.</i> 2. <i>V. K. Balakrishnan: Graph Theory, Schaum's outline series, Mc-Graw Hill, 1997.</i> 														
Plani i dizajnuar i mësim:															
Java	Ligjërata që do të zhvillohet														

Java e parë:	Njohja e studentëve me materien e kursit dhe procedurat e vlerësimit. Hyrje në Modelimin matematikor. Disa shembuj nga jeta e përditshme.
Java e dytë:	Modelimi matematikor për të shprehur rritjen e popullatës, apo edhe të një kapitali.
Java e tretë:	Aplikimi i Metodës së katrorëve më të vegjël në modelimin matematikor, si dhe ekuacioneve të differencës të rendit të parë dhe rendit të dytë.
Java e katërt:	Aplimi i shumëzuesve të Lagrange-it për njehsimin e vlerave ekstreme të funksioneve me shumë ndryshore. Zbatime të ndryshme të kësaj metode në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga jeta reale.
Java e pestë:	Gjeometria konvekse në një hapësirë vektoriale.
Java e gjashtë:	Hyrje në programimi jolinear. Programimi kuadratik. Programimi konik.
Java e shtatë:	Testi I
Java e tetë:	Elemente nga kompleksiteti i algoritmeve. Komplexiteti i Metodës simplekse të PL.
Java e nëntë:	Metoda e pikave të brendshme.
Java e dhjetë:	Funksionet konvekse dhe ato konkave dhe vetitë e tyre. Minimizimi dhe maksimalizimi i vlerave të funksioneve konvekse.
Java e njëmbëdhjetë:	Ekuacioni i transportit dhe zgjidhja e tij.
Java e dymbëdhjetë:	Modelimi matematikor i problemit të rrjedhës së trafikut dhe zgjidhja e tij.
Java e trembëdhjetë:	Ekuacioni i nxehtësisë në një domenë të kufizuar dhe zgjidhja e tij.
Java e katërbëdhjetë:	Ekuacioni i valëve dhe zgjidhja e tij.
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjariizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimin, do të jetë i ndaluar.

Funksionet speciale

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës	Probabilitet dhe statistikë		
Niveli	Master		
Statusi lëndës	O		
Viti i studimeve	I (Sem. II)		
Numri i orëve në javë	3+2		
Vlera në kredi – ECTS	6		
Koha / lokacioni	Departamenti i Matematikës		
Mësimdhënësi i lëndës	dr. sc. Bujar Fejzullahu		
Detajet kontaktuese	bujar.fejzullahu@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Ky kurs ofron të kuptuarit e koncepteve bazë, termave dhe rezultateve të teorisë së probabilitetit dhe statistikës matematike, si dhe kuptimin dhe zbatimin e saktë të modeleve të testimit statistikor dhe regresionit.		
Qëllimet e lëndës			
	Qëllimi i lëndës është të njoftohen studentët me parimet themelore të probabilitetit dhe statistikës si dhe aplikimi i tyre në modelimin dhe zgjidhjen e problemeve nga fusha të ndryshme.		
Rezultatet e pritura të nxënies			
	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Dijnë gjasën e kushtëzuar dhe kuptimet që lidhen me të; • Definoj varshmërinë e ndryshoreve të rastit si dhe të analizoj lidhshmërinë ndërmjet tyre; • Formuloj teoremat limite; • Identifikoj shpërndarjet e derivuara nga shpërndarja normale; • Njohin konceptet bazë dhe rezultatet e statistikave matematikore. • Identifikojnë testet mbi matjen e besueshmërisë. • Aplikojnë modelet e testimit statistikor, regresionit si dhe metodat jo-parametrike të analizës. • Ndërtojnë modele regulare; • Analizojnë efektet e ndikimit të koeficientëve; • Aplikojnë njohuritë e fituara, në zgjidhjen e problemeve të ndryshme; • Përdorë softuere dhe simulime për llogaritje statistikore. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45

Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			165

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, seminare, kollokuiume, provime.
Metodat e vlerësimit:	Detyrat e shtëpisë (10%), Seminare (10%), Kollokuiumi i parë (20%), Kollokuiumi i dytë (20%), Testi final (40%). Kriteri i kalueshmërisë është mbi 50% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit.
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> B. Fejzullahu, Bazat e teorisë së gjasës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2021.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> J. Rice, Mathematical statistics and data analysis, Duxbury Press, California, 2007. H. T. Nguyen, G. S. Rogers, Fundamentals of Mathematical Statistics, Springer Verlag, 1989. G. Schay, Introduction to probability with statistical applications. Birkhäuser, Boston, 2007.

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë</i>	Gjasa dhe gjasa e kushtëzuar
<i>Java e dytë</i>	Ndryshoret e rastit të pavaruara dhe të varuara
<i>Java e tretë</i>	Shpërndarjet e kushtëzuara
<i>Java e katërt</i>	Shpërndarjet e funksioneve të ndryshoreve të rastit
<i>Java e pestë</i>	Kovariansa dhe korelacioni
<i>Java e gjashtë</i>	Parametrat e kushtëzuar
<i>Java e shtatë</i>	Teoremat limite
<i>Java e tetë</i>	Shpërndarjet e derivuara nga shpërndarja normale
<i>Java e nëntë</i>	Shpërndarja e mostrave

<i>Java e dhjetë</i>	Vlerësimi i parametrave
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Testimi i hipotezave
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Analiza e variansës
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Regresioni linear
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Analiza e të dhënave kategorike
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Pako softuerike për statistikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Programim funksional		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	E		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Kursi do të ofrohet në anglisht		
Mësimdhënësi i lëndës:	Faton Berisha		
Detajet kontaktuese:	faton.berisha@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Kursi ofron një hyrje gjithpërfshirëse në fushën e programimit funksional. Kursi do të prekë disa nga metodat e analizës programore dhe teoritë mbështetëse, si dhe teknikat dhe aplikacionet bashkëkohore.		
Qëllimet e lëndës			
	Qëllimi kryesor i kursit është një ekspozitë mbi fundamentet e programimit të pastër funksional dhe zbatimin e koncepteve të programimit funksional për kodim efikas në gjuhët kryesore programuese.		
Rezultatet e pritura të nxënies			
	Pas përfundimit me sukses të kursit, studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojnë parimet themelore të programimit të pastër funksional dhe të zgjidhin probleme duke zbatuar këto parime. • të kenë shkathtësi të kodojnë në gjuhën programuese funksionale Haskell. • të investigojnë, vlerësojnë dhe krahasojnë programe në Haskell për nga korrektësia sintaksore dhe semantike, përgjithësimi, rishfrytëzueshmëria, efikasiteti dhe vetitë performuese. • të zbatojnë teknikat e programimit funksional në paradigmen e orientuar nga objektet në gjuhën programuese Java. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	11	1	11

Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			180
Metodologjia e mësimdhënies:			
<i>Ligjërata, diskutime, detyra shtëpie, prezantime</i>			
Metodat e vlerësimit:			
Pjesëmarrja (10%), Detyra të shtëpisë (30%), kollokuimi (30%), Provimi final (30%)			
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. S. Thompson, Haskell: The Craft of Functional Programming 2. Nielson, H. R. Nielson, C. Hankin, Principles of Program Analysis 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. D. Schmidt, Programming principles in Java: Architecture and interfaces 		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
1	Introduction to functional programming		
2	Getting started with Haskell		
3	Basic types and definitions		
4	Designing and writing programs		
5	Data types, tuples and lists		
6	Programming with lists		
7	Defining functions over lists		
8	I/O in Haskell		
9	Reasoning about programs		
10	Generalization: patterns of computation		
11	Higher-order functions		
12	Developing higher-order programs		
13	Overloading, type classes and type checking		
14	Algebraic types		
15	Functional, imperative and OO programming		

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në leksione, ushtrime dhe provime është e detyrueshme. Studentët pritet të kontribuojnë me diskutimet dhe detyrat e tyre të shtëpisë. Ata inkurajohen të marrin pjesë në orët e punës. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por nxënësit inkurajohen të diskutojnë me njëri-tjetrin për sa kohë që u japin kredi të gjithë kontribuesve në një zgjidhje. Ndershmëria akademike është e detyrueshme.

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Programim kompjuterik		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	O		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	7		
Koha / lokacioni:	Kursi do të ofrohet në anglisht		
Mësimdhënësi i lëndës:	Faton Berisha		
Detajet kontaktuese:	faton.berisha@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Nocioni dhe notacioni i kompleksitetit. Algoritmat rekursivë: Kompleksiteti. Sortimi: Analiza e algoritmave, kompleksiteti mesatar. Disenjimi i algoritmave efikasë. Problemet kompleksë: Klasat P dhe NP. Paradigma e programimit të orientuar nga objekte dhe Java. Bazat e inxhinierimit të softuerit të orientuar nga objekte: UML.		
Qëllimet e lëndës:			
	Kursi ofron ekspozë mbi disenjimin efikas të algoritmave dhe analizën precize të kompleksitetit teorik dhe praktik të tyre. Studiohen poashtu probleme komplekse dhe algoritma efikas të përafërt. Zbatohen shablone disenji në paradigmen e programimit të orientuar nga objekte dhe arkitekturën MVC.		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Pas përfundimit me sukses të kursit, studenti do të jetë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> të jenë në gjendje të disenjojnë algoritma efikas për probleme të ndryshme gjenerike në programim dhe të analizojnë kompleksitetin e tyre të zbatojnë algoritma të përafërt për zgjidhjen e problemeve komplekse të kenë shkathtësi të avancuara programimi sipas paradigmës OOP duke zbatuar shablone gjenerike disenji dhe arkitekturë standarde MVC. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	6	15	90

Përgatitja përfundimtare për provim	11	1	11
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			210
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<i>Ligjërata, diskutime, detyra shtëpie, prezantime</i>		
Metodat e vlerësimit:			
	Pjesëmarrja (10%), Detyra të shtëpisë (30%), kollokuimi (30%), Provimi final (30%)		
Literatura			
Literatura bazë:			
	<ol style="list-style-type: none"> 1. G. Brassard, P. Bratley: Algorithmics 2. T. H. Cormen, C. E. Leiserson, R. L. Rivest, C. Stein: Introduction to Algorithms 		
Literatura shtesë:			
	<ol style="list-style-type: none"> 3. M. H. Alsuwaiyel: Algorithms - Design Techniques and Analysis 4. E. Knuth: The Art of Computer Programming, Vols. 1, 2, 3 5. H. S. Wilf: Algorithms and Complexity 		

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
1	The notion of complexity and notation
2 – 4	Recursive algorithms: Complexity
5 – 6	Sorting: Algorithm analysis
7 – 8	Average-case complexity
9 – 10	Designing efficient algorithms
11 – 12	Complex problems: P and NP classes
13	Object oriented programming paradigm in Java
14 – 15	Basics of object oriented software engineering: UML

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Pjesëmarrja në leksione, ushtrime dhe provime është e detyrueshme. Studentët pritet të kontribuojnë me diskutimet dhe detyrat e tyre të shtëpisë. Ata inkurajohen të marrin pjesë në orët e punës. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por nxënësit inkurajohen të diskutojnë me njëri-tjetrin për sa kohë që u japin kredi të gjithë kontribuesve në një zgjidhje. Ndershmëria akademike është e detyrueshme.</p>	

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN)
Titulli i lëndës:	Siguria në sisteme kompjuterike
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i dytë / Semestri i tretë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	N/A, FSHMN
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. sc. Artan Berisha
Detajat kontaktuese:	artan.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Në këtë kurs temat përfshijnë hyrje teorike të kriptografisë, kriptosistemet me çelës simetrik, kriptosistemet me çelës asimetrik, funksionet njëkahëshe, nënshkrimet digjitale, lakoret eliptike, protokollet kriptografike dhe sfondin matematikor të nevojshëm për t'i sqaruar ato.
Qëllimet e lëndës:	Studentët do të mësojnë zbatimin e teorisë për sigurinë e të dhënave duke përfshirë edhe njohjen nga kërcënimet e mundshme të konfidencialitetit dhe integritetit. Do të mësojnë për algoritmat e thjeshtë të përdorur që nga koha e romakëve, algoritmat simetrik DES dhe AES, algoritmat asimetrik RSA (faktorizimi i numrave të thjeshtë), EL-Gamal (logaritmi diskret), lakoret eliptike, funksionet njëkahëshe SHA-1, SHA-2 dhe SHA-3. Krahas algoritmave do të mësojnë aplikim e njohurive nga matematika dhe zbatimin e saj në ndërtimin e algoritmave modern.
